

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**  
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

**P.nr.1138/2018**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm**, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Bekim Veliqi, procesmbajtëse Valdete Sadiku, në çështjen penale ndaj të pandehurit Gj.Gj, nga fsh. ..., Komuna e ..., nën dyshimin për veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.2064/2018, dt.17.12.2018, e përfaqësuar nga Prokurori i Shtetit Sllobodan Bakiq, në prezencë të pandehurit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar e cila ka qenë e hapur dhe publike, në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 366, të KPP-së, me dt.06.05.2019 është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.10.05.2019;

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari;**

**GJ.GJ**, me nofken "...", nga i ati M., e ëma M., e gjinisë P., i lindur me dt. ..., në ..., me vendbanim në fsha. ... Komuna e ..., punëtorë, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes jo të mirë ekonomike.

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE;**

Me dt. 01.12.2017, rreth orës, 12:40 min, në rrugën "..." ne ..., lehtësisht duke menduar që deri të aksidenti rrugorë nuk do të vij dhe që do të mundë të evitohet në kundërshtim me nenin 53 dhe nenin 233 par. 2 pika 2.2 Ligji mbi sigurimin e trafikut publik, në atë mënyrë ka drejtuar automjetin e tipit "Opel Zafra", me ngjyrë të verdhë, me tabela të regjistrimit ... ku në ndikim të alkoolit nga 3.74 promila (në frymëmarrje), ku në rast të pa përshtatjes së shpejtësisë në kushtet dhe gjendjes me rrugen nuk ka mundur që të ndalet, por ka vazhduar lëvizjen e automjetit nën shkallët në drejtim të rrugës "..." dhe e ka goditur këmbësorin H.K., duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe atë; prania e ajrit në hapësira të lira mediastinumit, në hapësirat e lira të gjoksit dhe hapësirën nën cipat e mushkërisë së majtë, plagët shqyese ndrydhëse, në regjionin balloromuror të anës së djathtë të kokës, ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kokës dhe qafës, përdredhja e qafës dhe thyerje serike e brinjëve të anës së majtë NI-VIII, të gjitha këto lëndime të natyrës së rëndë trupor me pasoja të përkohshme në shëndet, dhe me pjesën e përparme të automjetit e godet murin e betonit ku dhe aty ndalet.

**Me këtë ka kryer veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 41, 45,67, 73,74,75,76 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, të KPP-së i;

**S H Q I P T O N**

**I. DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, të cilin dënim do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**II.** Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizën e ekspertit të komunikacionit shumë prej 40.88€, për ekspertizën mjeko ligjor në shumë prej 20.00€, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20€, si dhe 30€ në emër të Fondit për

kompensim të viktimave, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Pala e dëmtuar për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil-juridik.

**III.** Gjyqtari gjykues pas publikimit të aktgjykimit dhe pëlqimit të të akuzuarit, duke vendosur sipas nenit 47 të KPRK-së, e zëvendëson dënimin e lartshënuar me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh në **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **2000€** (dymijë euro), ashtu që i akuzuari është i obliguar që shumën e caktuar të e paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast të mos pagesës së dënimit me gjobë do të ekzekutohet dënimi me burgim i përcaktuar si me lart.

**IV.** Gjykata në mbështetje të nenit 62 par.2 pika 2.5 lidhur me nenin 67 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

### **DËNIMIN PLOTËSUES**

**NDALIMIN E DREJTIMIT TË AUTOMJETIT** në afat prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, sipas kategorive të konstatuara në patentë shoferin e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës nr. ..., dt. ..., për kategoritë "B1, B, C1,C, BE si dhe ndalim i drejtimit të automjetit sipas kategorive të konstatuara në patentë shoferin e lëshuar nga Republika e Serbisë me nr. ... i dt. ..., për kategoritë AM, B1,B,BE, C1, C.

**NDALIMI I DREJTIMIT TË AUTOMJETIT** vlen për territorin e Republikës së Kosovës, që do të mbikëqyret nga institucionet e autorizuara, mos respektim i ndalimit të drejtimit të automjetit nga i akuzuari bartë pasojat ligjore sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i përgjithshëm, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.nr.2064/2018, dt.17.12.2018, ndaj të pandehurit Gj.Gj, nga fsh. ... Komuna e ..., për veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, ka prezantuar Prokurori i Shtetit Sllobodan Bakiq, i pandehuri Gj.Gj, është vazhduar me mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar.

Gjatë kësaj seance të shqyrtimit fillestar i pandehuri është udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tij komfor nenit 246 par.1 të KPP-së, pas deklarimeve të të pandehurit është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e kupton aktakuzën dhe pas bindjes së gjyqtarit se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, i është ofruar mundësia që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm, ku i pandehuri është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurin për pasojat e pranimin të fajësisë duke e njoftuar se për veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së, përcakton se kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, po ashtu gjykata e ka njoftuar të pandehurin se sipas nenit 383 par.2 të KPP-së në rast të pranimin të fajësisë nga i pandehuri i njëjti nuk e ka të drejtën e ushtrimit të ankesës për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, po ashtu pranimin e fajësisë gjykata do ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese në rastin e matjes së dënimit

I pandehuri ka deklaruar se i kupton pasojat e pranimin të fajësisë dhe rrethanat lehtësuese që i merr gjykata me rastin e matjes së dënimit dhe i pandehuri qëndron pranë pranimin të fajësisë.

Në mbështetje të nenit 248 par.2 të KPP-së, është kërkuar mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me deklarimin e të pandehurit për pranimin e fajësisë, i cili ka deklaruar që të pranoj pranimin e

fajësisë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është i vullnetshëm dhe pa imponim i bazuar në ligj dhe i mbështetur në provat materiale mbi bazat e së cilës është ngritur edhe kjo aktakuzë, gjykata në këtë rast të mos merr parasysht rrethanat lehtësuese për shkak se i njëjti ka qenë në ndikim të alkoolit dhe se gjykata e ka të drejtën edhe për shqiptimin e dënimit plotësues.

Pas kësaj gjyqtari është i bindur se i akuzuari e kupton natyrën e pranimit dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkëlqje të qartë ligjore ose gabime faktike andaj Gjyqtari në procesverbal në kuptim të nenit 248 par.4 e lidhur me par.1 nenpar.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 të KPP-së, ka marrë aktvendim duke pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit, pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi i fajësisë mbështet në provat materiale.

I akuzuari pas pranimit të fajësisë nga ana e Gjykatës ka shtuar se me vjen keq për atë se çfarë ka ndodhur, dhe se e gjitha është për shkak se atë ditë kam qenë në ndikim të alkoolit, mirëpo atë ditë jam bërë baba, për atë shkak kam konsumuar alkool, jam i gatshëm që ti ndihmoj të dëmtuarit po ashtu dhe familjes së tij, jam fajtor për këtë vepër, po ashtu gjykatën e njoftoj se jam baba i dy fëmijëve dhe kërkoj nga gjykata ti merr parasysht këto rrethana dhe të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Pasi që Gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe me që nga palët nuk ka pasur propozime të reja për plotësimin e procedurës gjyqtari i çështjes e ka shpallur përfundimin e këtij shqyrtimi dhe i ka njoftuar palët se Gjykata ka vazhduar në mbështetje të nenit 248 par.4 të KPP-së, me shqiptimin e dënimit - respektivisht me shpalljen publike të aktgjykimit, e cila shpallja e aktgjykimit është bërë po të njëjtën ditë, shpallja ka qenë e hapur dhe publike, në prezencë të të pandehurit dhe në mungesë të Prokurorit të Shtetit, ku Gjyqtari gjykues pas publikimit të aktgjykimit dhe pëlqimit të të akuzuarit, duke vendosur sipas nenit 47 të KPRK-së, e zëvendëson dënimin e lartshënuar me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh në **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **2000€** (dymijë euro).

Në lidhshmëri të pranimit të fajësisë nga i pandehuri në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 361 të KPP-së, gjykata vërtetoi se ekzistojnë prova materiale se në veprimet e të pandehurit kemi të bëjmë me elementet e veprës penale me të cilën akuzohet, kjo konstatohet nga deklarata e të pandehurit dt.08.12.2017, deklarata e dëshmitarit M.T. e dt.04.12.2017, deklarata e të dëmtuarit H.K. e dt.26.12.2017, foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, ekspertiza e komunikacionit dhe konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit ku ka konstatuar se lëshimet janë të të pandehurit e dt.10.09.2018, nga raportet mjekësore për të dëmtuarin H.K., ekspertiza mjeko ligjore e dt.05.12.2018 mbi natyrën e lëndimit trupor që ka konstatuar se natyra e lëndimit është e natyrës së rëndë trupore për të dëmtuarin H.K., andaj të gjitha këto vërtetojnë rrethanat për gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me këto veprime përmbushen – krijohen elementet e veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së, të gjitha rrethanat si më lart tregojnë gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartsisë së dënimit për të pandehurin gjykata pati parasysht të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73, 74 par.3 pika 3.10, 75, 76 par.1 pika 1.6 të KPRK-së, në zbutjen e dënimit duke e vlerësuar pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes, premtimin e tij se në të ardhmen do të përmbahet nga veprime të paligjshme, deklarimin e tij se tani nuk konsumon alkool, shprehjen e gatishmërisë që ti ndihmoj të dëmtuarit po ashtu dhe familjes së tij, duke vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-së, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të beje rehabilitimin e tij dhe se të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, po edhe të kësaj natyre, duke vlerësuar se i pandehuri do të përmbahet nga veprime të tjera të paligjshme.

Gjykata sipas detyrës zyrtare në mbështetje të nenit 62 par.2 pika 2.5 lidhur me nenin 67 të KPRK-së, të pandehurit i ka shqiptuar dënimin plotësues Ndalimin e drejtimit të automjetit në afat prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, sipas kategorive të konstatuara në patën shoferin e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme Republika e Kosovës nr. ..., dt. ..., për kategoritë "B1, B, C1,C, BE si dhe ndalim i drejtimit të automjetit sipas kategorive të konstatuara në patentë shoferin e lëshuar nga Republika e Serbisë me nr. ... dt, ..., për kategoritë AM, B1,B,BE, C1, C.

Ndalimi i drejtimit të automjetit vlen për territorin e Republikës së Kosovës, që do të mbikëqyret nga Institucionet e autorizuara, mos respektim i ndalimit të drejtimit të automjetit bartë pasojat ligjore për të akuzuarin sipas neni 401 të KPRK-së, pasi që si rrethana ka vlerësuar veprimet e të pandehurit duke e drejtuar automjetin në ndikim të alkoolit, duke rrezikuar jetën e pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, e që si pasojë e një veprimi të tillë të pandehurit i është shkaktuar lëndime të natyrës së rënde trupore, gjykata ka vlerësuar që të pandehurit të i ndalohej drejtimi i automjetit për kohën e caktuar si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, me njoftimin edhe të pasojave ligjore në rast të mos respektimit të vendimit të gjykatës.

Shpallja e aktgjykimit është bërë po të njëjtën ditë në mënyrë publike në prezencë të të pandehurit, ndërsa në mungesë të Prokurorit të Shtetit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori konform neneve 450 dhe 451 të KPP-së, ndërsa udhëzimi i palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil u mbështet në nenin 463 të KPP-së.

Nga theksimet e theksuara si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr.1138/2018, dt.10.05.2019**

**Procesmbajtësja**  
**Valdete Sadiku**

**Gjyqtari**  
**Bekim Veliqi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.